



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 200, datë 13.12.2024

PËR

**AKREDITIMIN PERIODIK TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
MASTER I SHKENCAVE "ADMINISTRIM BIZNESI" ME PROFILE, "I
PËRGJITHSHËM", "MENAXHIM", "MENAXHIM I BURIMEVE NJERËZORE",
"MARKETING", "MENAXHIM I SISTEMEVE TË INFORMACIONIT", "BANKË", TË
UNIVERSITETIT TË NEW YORK-UT NË TIRANË**

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike", Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 24.12.2021, "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 2, datë 07.04.2017, "Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit" dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 224, datë 15.12.2023 "Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit", në mbledhjen e tij të datës 13.12.2024, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" me profile, "I Përgjithshëm", "Menaxhim", "Menaxhim i Burimeve Njerëzore", "Marketing", "Menaxhim i Sistemeve të Informacionit", "Bankë", me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Master i Shkencave në "Administrim Biznesi" me profile, "I Përgjithshëm", "Menaxhim", "Menaxhim i Burimeve Njerëzore", "Marketing", "Menaxhim i Sistemeve të Informacionit", "Bankë"
- b) Cikli i studimit: Cikli i dytë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 618, datë 26.12.2011
- d) Akreditimi periodik: Vendim i Bordit të Akreditimit Nr.73, datë 04.10.2019
- e) Institucioni që e ofron: Universiteti i New York-ut në Tiranë
- f) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Administrim Biznesit
- g) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 2 vite / 4 semestra

- h) Kredite (ECTS): 120 kredite
- i) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- j) Gjuha e mësimdhënies: Anglisht
- k) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Universiteti i New York-ut në Tiranë
- l) Niveli i diplomës në kuadrin e Komizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 7

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- e. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- f. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;
- g. Shkallën e përmbushjes së rekomandimeve të lëna nga akreditimi periodik;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuar përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i akreditimit periodik të këtij programi ka qënë pozitiv, me rekomandime;
- f. Institucioni ka përmbushur rekomandimet e lëna nga akreditimi periodik;
- g. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimin të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”* dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit, është **“i përmbush kryesisht standardet”**, me mangësi si më poshtë:
 1. Kualifikimi i disa prej anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, nuk është në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.
 2. Kategoritë e veprimtarive formuese të kurrikulës dhe syllabuset e këtij programi studimi , nuk janë plotësisht në përputhje me parashikimet nënligjore në fuqi.
 3. Mungesa e përditësimit të kurrikulës së këtij programi studimi me lëndë të reja, në vitet e fundit.
 4. Mobiliteti i studentëve të këtij programi studimi, është i ulët.
 5. Numri i studentëve të regjistruar në disa prej profileve të këtij programi studimi është i ulët, e si rrjedhojë ndikon në përvojën e të nxënit të studentëve.

VENDOSI:

1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” me profile, “I Përgjithshëm”, “Menaxhim”, “Menaxhim i Burimeve Njerëzore”, “Marketing”, “Menaxhim i Sistemeve të Informacionit”, “Bankë”, të Universitetit të New York-ut në Tiranë.
2. Akreditimin e programit të studimit me kohëzgjatjen prej 4 (katër) vite.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **12.12.2028**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT


SHQIPONJA TELHAJ		Kryetare
ALEXANDER KOHLER		Anëtar
AYŞEN SAVAŞ SARGIN		Anëtar
TOMASZ JELENSKI		Anëtar
IRAJ HASHI		Anëtar
MAURICE OUDEJANS		Anëtar
LEA YPI		Anëtar

KITA SALLABANDA DIAZ



Anëtar

DARINKA PIQANI




Anëtar

DRITAN NAÇE



Anëtar

INDRIT HOXHA



Anëtar

Shënim: Znj. Lea Ypi nuk mori pjesë në këtë mbledhje.

:

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 200, datë 13.12.2024, “Për akreditimin periodik të programit të studimit Master i Shkencave në “Administrim Biznesi” me profile, “I Përgjithshëm”, “Menaxhim”, “Menaxhim i Burimeve Njerëzore”, “Marketing”, “Menaxhim i Sistemeve të Informacionit”, “Bankë”, të Universitetit të New York-ut në Tiranë, janë si vijon:

1. Institucioni, të marrë masa që kualifikimi i anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, të jetë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.
2. Institucioni, të rishikojë kategoritë e veprimtarive formuese të kurrikulës dhe syllabuset e këtij programi studimi ,në përputhje me parashikimet nënligjore në fuqi.
3. Institucioni, të përditësojë kurrikulën e këtij programi studimi, me qëllim përfshirjen e lëndëve të reja në fushën e sipërmarrjes.
4. Institucioni, të nxisë më tej studentët e këtij programi studimi për të marrë pjesë në programet e mobilitetit.
5. Institucioni, të shtojë përpjekjet për rritjen e numrit të studentëve ose të zvogëlojë numrin e profileve të këtij programi studimi, me qëllim rritjen e numrit të studentëve në klasa individuale, në mënyrë që të përmirësojë përvojën e të nxënit të studentëve.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Universiteti i New York-ut në Tiranë**, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 6 (gjashtë) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

